

VENDIM
Nr. 521, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRIT TË SHTETIT DHE KRYENEGOCIATOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator është drejtimi teknik i negociatave dhe bashkërendimi i brendshëm i procesit të përgatitjeve të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet zhvillimit të procesit teknik të negocimit, plotësimit nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të kushteve dhe kriterëve për mbylljen e negociatave dhe anëtarësimit, nismave për integrimin e përsheptuar, bashkërendimit të përafrimit të legjislacionit vendës me atë të Bashkimit Evropian, bashkërendimit të prioritetëve, hartimit dhe propozimit të politikave, në kuadër të procesit të anëtarësimit, bashkërendimit të kuadrit strategjik të lidhur me anëtarësimin, zhvillimit të kapaciteteve, rritjes së performancës për arritjen e rezultateve, si dhe informimit të publikut për këto procese, integrimi në Bashkimin Evropian, si dhe bashkërendimi i konsultimeve me biznesin dhe grupet e interesit në çështjet për integrimin evropian.

3. Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Bashkërendon procesin e brendshëm të përgatitjeve për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;

b) Bashkërendon prioritetet e politikave shtetërore dhe politikëbërjen, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

c) Bashkërendon, harton politikat dhe kuadrin strategjik, në lidhje me anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe i bën propozime Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian dhe Këshillit të Ministrave;

ç) Koordinon punën e grupit negociator të Republikës së Shqipërisë për plotësimin nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të kushteve dhe kriterëve për përmbylljen e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian;

d) Kryen, së bashku me grupin negociator të Republikës së Shqipërisë dhe në drejtim të tij, negociatat teknike të anëtarësimit në Bashkimin Evropian për të gjithë grup-kapitujt (*clusters*) dhe kapitujt negociues, si dhe bashkërendon punën për përgatitjen e institucioneve shqiptare;

dh) Bashkërendon punën për kontributin nga negociatat teknike e grupit negociator të Republikës së Shqipërisë në procesin e përgatitjes nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Traktatit të Anëtarësimit (dhe akteve e dokumentacionit shoqërues) në Bashkimin Evropian;

e) Bashkërendon punën e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera për hartimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian dhe ndjek ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendës me atë të Bashkimit Evropian nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera;

ë) Bashkërendon hartimin e agjendës së reformave në të gjithë sektorët, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

f) Bashkërendon dhe ndjek zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian nga institucionet shqiptare, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

g) Bashkërendon dhe nxit nismat e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera në lidhje me integrimin e përsheptuar (gradual), me fokus, veçanërisht, në institucionet e Bashkimit Evropian dhe Tregun e Përbashkët të Bashkimit Evropian;

gj) Propozon projektakte, që kanë lidhje me procesin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;

h) Nxit dhe mbështet ngritjen e mekanizmave metodologjikë, platformave, instrumenteve dhe mjeteve të lidhura me negociatat dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian, si dhe për politikën publike dhe reformat, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

i) Bashkërendon punën për zhvillimin e kapaciteteve dhe mbështetjes për institucionet shqiptare për procesin e negociatave dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian, si dhe politikëbërjen;

j) Bashkërendon punën për hartimin e kuadrit, si dhe zbatimin nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të programeve e të nismave për informimin e publikut për çështjet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

4. Vendimi nr. 517, datë 29.7.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet ministri i Shtetit dhe Kryenegociator për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama